



Shqip

Fletëpalosje: Informacione / Rregullat e shkollës / Marrëveshjet

Nxënëse e dashur, Nxënës i dashur

Ju keni vendosur ta ndiqni një shkollë ndërlidhëse (Brückenangebot). Këtë vit dëshironi të përfitonit shumë dhe të përmirësoni mundësitë tuaja për një profesion në të ardhmen. Ju edhe do ta arrini këtë qëllim nëse jeni të gatshëm për tu angazhuar seriozisht dhe intensivisht në këtë drejtim. Ju urojmë shumë gëzime dhe suksese në shkollën tonë.

Të dashur prindër

Edhe ju shpresoni se djali / vajza juaj do të bëjë përparim në zhvillimin personal duke i ndjekur mësimet në një shkollë ndërlidhëse (Brückenangebot). Në mënyrë që të jemi të suksesshëm, ne si shkollë, varem nga mbështetja juaj (pavarësisht moshës së djalit / vajzës suaj). Informacionet dhe marrëveshjet e mëposhtme e ndërtojnë bazën e një bashkëpunimi të suksesshëm.

Viti shkollor

Nxënëset dhe nxënësit regjistrohen në shkollë për një vit të plotë shkollor. Duke vepruar kështu, ata zotohen ta ndjekin mësimin **gjatë gjithë vitit shkollor**.

Pushimet

Nëse për arsye të parashikueshme nuk mund ta ndiqni shkollën, atëherë aplikoni për pushim. Ju mund t'i merrni formularët e pushimit nga mësuesja / mësuesi kujdestar i klasës. Kërkesat duhet të dorëzohen jo më vonë se 8 ditë para datës së pushimit.

Nxënëset dhe nxënësit në shkollën tonë tashmë e kanë përfunduar shkollimin e tyre të detyrueshëm. Ata tani janë kryesisht në një pozitë të barabartë me nxënësit që mësojnë për zanat. Kjo është arsyeja pse pushimet jepen shumë rrallë dhe në raste shumë të rëndësishme.

Zgjatjet e pushimeve ose fillimi i mëhershëm i pushimeve lejohen vetëm nëse keni një konfirmim nga punëdhënësi i prindërve në të cilin thuhet se pushimet vjetore nuk mund të merren ndryshe. **Kërkesat për pushim për shkak të fluturimeve më të lira do të refuzohen.**

Aktivitetet shkollore / Mësimi jashtëshkollor

Nxënëset dhe nxënësit duhet të ndjekin të gjitha lëndët e arsimit bazë, lëndët e specialitetit dhe lëndët me zgjedhje që kanë zgjedhur. Ata do të marrin pjesë në të gjitha ekskursionet dhe aktivitetet që shkolla i ka shpallur të detyrueshme.

Fotografitë dhe videoincizimet

Nëse nxënëset dhe nxënësit ose kujdestarët e tyre ligjorë nuk duan që të bëhen fotografi dhe videoincizime për përdorim të brendshëm në shkollë (prezantime, uebfaqe, etj.), ata

mund të deklarohen lidhur me këtë me shkrim në fillim të vitit shkollor tek mësuesja / mësuesi kujdestar i klasës, e cila/ i cili e njofton më tej drejtorin/drejtoreshën e shkollës.

Përgatitja për zgjedhjen e profesionit

Gjatë përgatitjes për zgjedhjen e profesionit përgjegjësinë kryesore e mbajnë të rinjtë dhe prindërit e tyre. Sigurisht, ju do të mbështeteni në mënyrë aktive nga mësimdhënësit tanë. Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për ndihmë, ju lutemi kontaktoni mësuesen / mësuesin kujdestar të klasës në një fazë të hershme. Gjithashtu mund t'ju mbështesin edhe Këshillimoret për Profesionet!

Rregullat për mungesat

Ndjekja e mësimit në një shkollë ndërlidhëse është vullnetare. Duke u regjistruar, ju jeni zotuar se do ta ndiqni mësimin rregullisht. Për këtë arsye, ne presim që nxënëset dhe nxënësit të paraqiten në klasë në kohë dhe pa ndërprerje. Rregullorja për ndjekjen e shkollës si dhe për mungesat, përjashtimet dhe masat disiplinore (Urdhëresa për mungesat dhe masat disiplinore 410.130) zbatohet në rast mungese ose vonese në shkollë. Nëse një nxënëse ose një nxënës ka më shumë se 14 mungesa të paarsyeshme në një vit shkollor, atëherë iniciohet procedura (me përfshirjen e komisionit të shkollës) për përjashtim përfundimtar nga shkolla.

Mungesat e shkurtra, të arsyeshme (për shembull në rast sëmundjeje)

Në ditën e parë të mungesës në mësim, telefononi në shkollë nga ora 8.20 - 8.30 ose nga ora 10.00 - 10.30. Lajmëroni mësuesen / mësuesin kujdestar tuaj të klasës ose një mësues /mësues lëndor.

Si shënohen vonesat dhe mungesat në dëftesë?

- Vonesë në mësim konsiderohet kur nxënësi/nxënësjë nuk është në klasë në fillim të mësimit.
- Mungesë në mësim konsiderohet kur nxënësi/nxënësjë mungon për të paktën një orë mësimi (45 minuta). Për gjysmë dite në shkollë llogaritet një mungesë.

Letër arsyetimi/justifikimi për mungesat/vonesat

Letrën për arsyetimin/justifikimin e mungesës/vonesës nxënësit duhet t'ia dorëzojnë mësueses / mësuesit kujdestar të klasës jo më vonë se 8 ditë pas mungesës ose vonesës. Nëse këtë nuk mund ta bëni personalisht, për shembull për shkak të një sëmundjeje afatgjate, letra për arsyetimin/justifikimin e mungesës duhet të dërgohet me postë ose email brenda 8 ditëve. Letra për arsyetimin/justifikimin e mungesës përmban arsyen e mungesës dhe informacionin në lidhje me kohëzgjatjen. Në rastin e të rinjve të mitur, edhe prindërit duhet të nënshkruajnë letrën për arsyetimin/justifikimin e mungesës.

Mosha madhore: Nxënëset dhe nxënësit që janë mbi 18 vjeç

Nxënëset dhe nxënësit e shkollës që kanë mbushur moshën 18 vjeç janë të moshës madhore dhe veprojnë në mënyrë të pavarur në raport me shoqërinë, shtetin dhe shkollën. Mësimdhënësit megjithatë vazhdojnë t'i informojnë prindërit për gjëra të rëndësishme në lidhje me vitin ndërlidhës dhe suksesin e vajzave dhe djemve të tyre. **Nëse nxënësit e moshës madhore nuk dëshirojnë që ky informacion t'u përcillet prindërve të tyre, ata në fillim të vitit shkollor (ose në momentin kur e arrijnë moshën madhore) mund ta kërkojnë këtë me shkrim nga mësuesi kujdestar i klasës, i cili e njofton më tej drejtorin/drejtoreshën e shkollës.**

Shënim: Prindërit do të informohen gjithmonë për vendimet e rëndësishme (për shembull braktisja e shkollës, masat disiplinore, përjashtimi nga shkolla, etj.).

Rregullorja e kostos në rast braktisje ose përjashtimi nga shkolla gjatë vitit shkollor

Nëse, gjatë vitit shkollor, një nxënës e braktis shkollën pa pëlqimin e drejtorit të shkollës, ose nëse një i ri/e re përjashtohet nga shkolla për shkak të sjelljes së tij ose të saj, prindërit, kujdestarët ligjorë ose nxënësi/nxënësja i/e moshës madhore do të marrin një faturë prej 800 CHF.

Shënim: Ndjekja e mësimit në shkollat ndërlidhëse është falas. Sidoqoftë, mësimi kushton deri në 18.000 CHF në vit. Në rast braktisje të shkollës ose përjashtimi nga shkolla, klasa ka më pak nxënës se sa duhet. Shpenzimet pra mbeten të njëjta, ndërsa ndonjë nxënës/nxënëse tjetër nuk mund të përfitojë prej kësaj oferte.

Kjo rregullore e koston është pjesë e marrëveshjes së pranimit në shkollë dhe është e vlefshme që nga momenti i fillimit të shkollës.